



Raporti i Aftësisë së Studentit në LAS Links Shpjegim për Prindërit/Kujdestarët



LAS Links Assessment/ Vlerësimi në LAS Links është një provim i ndërtuar për të matur aftësinë dhe rritjen arsimore të studentit në gjuhën angleze.

Raporti i Studentit

Raporti i Studentit u jep prindërve dhe kujdestarëve informacion rreth rezultateve të provimit të fëmijës së tyre. Cdo vit LAS Links mat aftësinë e studentëve në gjuhën angleze në mjediset sociale dhe shkollore. Ky raport tregon rezultatet dhe nivelet e aftësive për secilën nga aftësitë e mëposhtme të gjuhës angleze:

- Në përgjithësi:
 - Rezultati i përgjithshëm është mesatarja e pikëve të shkallës së të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit dhe është një matës i fortë i aftësisë së përgjithshme të studentëve në gjuhën angleze.
- Fushat Kryesore të Aftësive:
 - Të folurit
 - Të dëgjuarit
 - Të lexuarit
 - Të shkruarit
- Fushat e Kombinuara të Aftësive:
 - Të Kuptuarit (Të Dëgjuarit + Të Lexuarit)
 - Produktive (Të Folurit + Të Shkruarit)
 - Me Gojë/Verbal (Të Folurit + Të Dëgjuarit)
 - Shkrim-lexim (Të Lexuarit + Të Shkruarit)

Rezultatet dhe Nivelet e Aftësisë

Pikët e Mundshme: Numri i përgjithshëm i pikëve që mund të fitohen në çdo fushë aftësie.

Pikët e Marra: Numri i pikëve që studenti fitoi për përgjigjet e sakta në secilën fushë aftësie.

Rezultati i shkallës: Numri i Pikëve të Fituara ndryshoi në një pikë që tregon përparimin e një nxënësi nga një vit shkollor në tjetrin. Çdo fushë aftësie ka shkallën e saj të pikëve, kështu që rezultatet nuk duhet të krahasohen përmes të gjitha fushave. Për shembull, mos krahaso një pikë të shkallës së Dëgjimit me një pikë të shkallës së të Folurit.

Niveli i Aftësisë: Pikët e shkallëve të çdo studenti vihen në një nga pesë nivelet, të cilat përshkruajnë aftësitë e tyre në gjuhën Angleze.

Përshkrime të Nivelit të Aftësisë

Niveli 1: Fillestar

Në nivelin e parë, nxënësi sapo ka filluar të komunikojë në shkollë, kryesisht nëpërmjet gjesteve dhe gjuhës së shtëpisë.

Niveli 2: I Ndërmjetmë i Hershëm

Në nivelin e dytë, studenti po përdor Anglishten, por me gabime të vazhdueshme që mund të pengojnë komunikimin.

Niveli 3: I Ndërmjetmë

Në nivelin e tretë, studenti po zhvillon aftësinë për të komunikuar në mënyrë efektive, por mund të bëjë gabime.

Niveli 4: I Aftë

Në nivelin e katërt, studenti mund të komunikojë efektivisht, por me disa gabime.

Niveli 5: Sipër/Mbi i Aftë

Në nivelin e pestë, nxënësi komunikon efektivisht për qëllime shoqërore dhe shkollore me pak, nëse ka, gabime.

Faqja e Dytë e Raportit të Studentëve

Në krye të faqes së dytë tregohen pikët e përfuara, pikët e mundshme dhe mesatarja e grupit të referimit (RGA) për çdo fushë aftësie. Mesatarja e grupit të referimit (RGA) është ecuria mesatare e pritshme e studentëve që morën pjesë në LAS Links.

Pjesa e poshtme e faqes së dytë përfshin një reference Lexile të bazuar në rezultatin e përgjithshëm të gjuhës Angleze të një studenti. Referenca Lexile përdoret për të matur aftësinë e leximit dhe duke përdorur këtë burim falas, mund të gjeni libra që mund të përmirësojnë leximin e fëmijës tuaj. Vetëm shko te fab.lexile.com dhe shkruaj numrin e referencës Lexile që ka marrë fëmija për të gjetur listat e librave.